

Shërbimet në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike

- 1. Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm.*
- 2. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.*
- 3. Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmytjet në zonat e banuara.*
- 4. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore.*
- 5. Ndriçimin e mjediseve publike.*
- 6. Transportin publik vendor.*
- 7. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike, si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit.*
- 8. Shërbimin e dekorit publik.*
- 9. Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike.*
- 10. Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.*
- 11. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.*
- 12. Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.*
- 13. Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.*
- 14. Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.*

Instrumentet për administrimin e shërbimeve publike

- 1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore sigurojnë dhënien e shërbimeve publike, nëpërmjet një ose më shumë instrumenteve të mëposhtme:*
 - a) njërive organizative të veta, që janë pjesë e strukturës administrative të njësisë vendore;*
 - b) ndërmarrjeve për shërbimet publike, sipas legjislacionit në fuqi;*
 - c) kontraktimit të dhënies së shërbimeve me palë të treta;*
 - ç) përdorimit të instrumenteve të përshtatshme të partneritetit publik dhe privat, sipas legjislacionit në fuqi*
 - d) krijimit të shoqërive tregtare në pronësi apo bashkëpronësi të njësisë vendore, sipas legjislacionit në fuqi.*
- 2. Në çdo rast, pavarësisht nga instrumenti i përzgjedhur, njëzia vendore do të jetë përgjegjëse për:*
 - a) hartimin dhe vendosjen e një sistemi administrimi të performancës së shërbimit, bazuar mbi standarde vendore dhe/ose standarde minimale kombëtare;*
 - b) hartimin dhe vendosjen e një sistemi treguesish, përfshirë edhe aspektin gjinor për matjen e performancës;*
 - c) krijimin e një njësie të posaçme në strukturën e njësisë së vetëqeverisjes vendore, e cila do të jetë përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës e të shërbimit, përfshirë edhe*

aspektin gjinor.

3. Njësia e vetëqeverisjes vendore mund të ofrojë mbështetje financiare për ndërmarrjet bashkiake për shërbimet publike dhe/ose për shoqëritë tregtare me kapital të njësisë së vetëqeverisjes vendore, fusha e veprimit të së cilës lidhet me dhënien e një shërbimi publik që është përgjegjësi e kësaj njësie.